



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIONI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TË KOSOVËS	KOSOVSKA AGENCIJA ZA ZAŠTITU SREDINE	KOSOVO ENVIRONMENTAL PROTECTION AGENCY
---	---	---

INSTITUTI I KOSOVËS PËR MBROJTJEN E NATYRËS

NJOFTIM

PËR VAZHDIMIN E KONSULTIMIT PUBLIK

Njoftohen të gjithë të interesuarit se **vazhdon edhe për 30 ditë konsultimi publik** për:

ARSYESHMËRITË PROFESIONALE PËR SHPALLJEN E 12 ZONAVE TË MBROJTURA NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PRIZRENIT

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, në kuadër të Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, me qëllim të sigurimit të informimit, transparencës dhe përfshirjes sa më të gjerë të qytetarëve, institucioneve, komuniteteve lokale, organizatave dhe të gjitha palëve të tjera të interesuara, **vazhdon konsultimin publik edhe për një periudhë shtesë prej 30 ditësh, nga data 25.09.2026 deri më 24.10.2026.**

Gjatë kësaj periudhe, të gjitha palët e interesuara mund të paraqesin komente, vërejtje dhe sugjerime lidhur me arsyeshmëritë profesionale për shpalljen e 12 zonave të propozuara për mbrojtje në territorin e Komunës së Prizrenit.

Komentet dhe sugjerimet e pranuar gjatë konsultimit publik të zhvilluar nga data 19.08.2026 deri më 18.09.2026 mbeten të vlefshme dhe do të trajtohen së bashku me komentet dhe sugjerimet që pranohen gjatë vazhdimit të konsultimit publik. Palët që kanë dorëzuar komente gjatë periudhës së parë nuk kanë nevojë që ato ti ridërgojnë.

Komentet dhe sugjerimet shtesë mund të dorëzohen deri më **24.10.2026, në orën 16:00**, në adresën elektronike: shkurte.selimi@rks-gov.net

Pas përfundimit të periudhës 30-ditore të konsultimit publik, **më 27.10.2026, duke filluar nga ora 10:00, do të mbahet debat publik në objektin e Kuvendit Komunal të Prizrenit.**

Në debat publik ftohen të marrin pjesë qytetarët, përfaqësuesit e Komunës së Prizrenit, komunitetet lokale, institucionet publike, organizatat e shoqërisë civile dhe të gjitha palët e tjera të interesuara, të cilat do të kenë mundësi të paraqesin qëndrimet, komentet, vërejtjet dhe propozimet e tyre lidhur me arsyeshmëritë profesionale dhe zonat e propozuara për mbrojtje.

Dokumentet, arsyeshmëritë profesionale dhe lista e **12 zonave të propozuara për mbrojtje** mbeten të njëjta me ato të publikuara në njoftimin e datës 19.08.2026 dhe vazhdojnë të jenë të qasshme në ueb-faqen zyrtare të Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (<https://ammk-rks.net/al/informata-njoftime>).

Prishtinë, 24.09.2026